



REPUBLIKA E KOSOVËS
Drejtoria e Inspektionit
Glogoc, me 01.08.2019



RAPORT PËR MUAJIN KORRIK 2019

Gjatë muajit Korrik janë bërë inspektime sipas sektorëve përkatës duke filluar nga shqyrtimi i kërkesave të qytetarve në të gjithë sektoret, pastaj është vazhduar me inspektime në teren sipas detyrave dhe agjendës ditore për secilin sektor të përcaktuar nga kërkesat e qytetarëve dhe menaxhmenti i D.I.

Në vazhdim po ju sjellë punët e kryera nga secili sektor sipas lëmvive të tyre përkatëse:

Sektori Sanitar

Në këtë muaj është vazhduar me inspektimin e subjekteve afariste hoteliere rreth kushteve higjenike dhe sanitare, në ato subjekte që kemi hasur në parregullësi është urdhëruar për përmirësim të tyre, gjithashtu janë ri - inspektuar ato subjekte që ka kaluar afati për përmirësim të parregullsive duke marrë të gjitha masat e nevojshme sipas Ligjit në fuqi.

Gjatë këtij muaji kemi shqyrtuar 3 kërkesa për pëlqim sanitar në ushtrimin e veprimtarisë, prej tyre një është refuzuar pasi që nuk i ka plotësuar kushtet sanitare (subjekte afariste hoteliere) ndërsa dy prej tyre janë pajisur me pëlqim.

Sektori i Ndërtimit

Janë inspektuar ndërtimet në Drenas, në veçanti ndërtimet pa leje në zonat e urbanizuara në afërsi të rrugëve regjionale dhe lokale, në zonën e tokës bujqësore nën masën e komosacionit dhe ndërtimet që bëhen në pronën komunale, pastaj është inspektuar shtrirja e rrjetit të KEDS-rreth vendosjes së shtyllave dhe kablllove elektrike, kthimi i sipërfaqeve të rrugës në gjëndje të më parshme, e kjo është bërë në bazë të ankesave të shumta të bëra nga banoret, lidhur me vendosjen e shtyllave elektrike. Gjatë zhvillimit të procedurave janë hartuar procesverbale të inspektimit, njoftime dhe përgjigje ndaj kërkesave.

Është bërë rrënimi i dy objekteve: ish objekti i qendrës sociale , dhe ish objekti i pylltarisë.

Sektori i Komunikacionit

Janë bërë inspektime të transportuesve legal dhe atyre ilegal , por vlen të theksohet se gjatë këti muaji kemi patur mungesë të theksuar të asistimit nga policia , sipas tyre për shkak të numrit të vogël të pjestarve të policisë dhe aksidenteve në komunikacion, por në momentet kur ka patur asistim të policisë kemi inspektuar transportuesit ilegal dhe janë marrë masa konform ligjit.

Sektori i Tregut

Janë inspektuar bizneset të cilat kanë ekspozuar artikujt jashtë lokali, është bërë shqyrtimi i kërkesave për dhënjën e pëlqimit për ushtrimin e veprimtarisë , lokalet që ushtrojnë veprimtarinë e që nuk janë të pajisura me pëlqime për ushtrim të veprimtarisë të pajisen me to, brenda afatit që i është dhënë me procesverbal.

Sektori i Mjedisit

Nga mjedisi është bërë shqyrtimi i kërkesave të palëve.

Në bashkëpunim me DSHPE dhe KRM “Pastrimi” në Drenas janë bërë inspektime në biznese në që nuk janë në sistem të menaxhimit të mbeturinave .

Gjatë këtij inspektimi kompania i ka pajisur me kontinjer banorët qe nuk kanë qenë në sistem , ndërsa ata të cilët nuk kanë pranuar ju është hartuar procesverbal.

Është bërë inspektim rutinor në mjedis për marrjen e masave për ndonjë parregullësi eventuale.

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punës në shifra për muajin Korrik , 2019

Sektori	Procesverbale	Aktvendime	Gjoba mandatore	Fletëparaqitje	Kërkesa për Pëlqim sanitar	Pëlqime Sanitare	Njoftime	Raporte	Kërkesa	Kallxime penale	Shqyrtim i kerk.	Mbyllje të lokalev	Konfiskim i targave dhe automjeteve	Konfiskim i mallit pa afat
Sanitari	11	0	1	0	0	0	0	0	3	0	3	0	0	0
Treg	12	1	3	0	0	0	0	0	4	0	1	0	0	0
Komunikacion	7	0	2	0	0	0	0	0	2	0	1	0	2	0
Ndërtim	23	0	0	0	0	0	3	3	5	0	5	0	0	0
Mjedis	16	0	1	0	0	0	0	0	4	0	4	0	0	0
Totali	69	1	7	0	0	0	3	3	18	0	14	0	2	0

Gusht ,2019

U.D Shef i D.I